



Prishtinë: 27.05.2009

Kodi i ZRRE-së: V_186_2009

Nr. I Referencës: ZRRE/DMK_R_222_05_09

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kapitullit 3, Nenit 16 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë dhe procedurat e paraqitura nga palët;
4. Rekomandimin e DMK të ZRRE-së: ZRRE/DMK_V_222_05_09;
5. Nenin 18 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë.

Në mbledhjen e mbajtur më 27 maj 2009 nxori këtë:

VENDIM

REFUZOHET ankesa e konsumatorit Musa Kutllovci, kafiteria “Te Memi” (shifra e konsumatorit DPR – 90024001) nga Prishtina, si në arsyet e paraqitura të këtij vendimi.

Arsyetim

Konsumatori në ankesën e tij drejtuar DMK të ZRRE-së të datës 27.04.2009 ka apeluar përgjigjen e KEK Sh.A – Divizioni i Furnizimit – Departamenti për Konsumatorë të datës 21.04.2009, lidhur me ngarkesën e shfrytëzimit të paautorizuar.

- Me datë 14.11.2007 zyrtarët e autorizuar të shërbimit të kontrollës kanë vizituar objektin e konsumatorit me qëllim të shkyçjes së konsumatorit nga rrjeti elektrik për shkak borxhit të konsumatorit në vlerën 3,953.00€.
Provë: Procesverbali i KE-ut nr. 027602 dhe fotot e njehsorit
- Me datë 13.02.2009 zyrtarët e autorizuar të shërbimit të kontrollës të KEK-ut kanë vizituar objektin e konsumatorit me qëllim të kontrollimit të njehsorit elektrik, dhe kane konstatuar se tri urat e tensionit janë të larguara me qëllim të konsumit të energjisë elektrike pa matje.
Provë: Procesverbali i KEK-ut nr. 270278 i datës 13.02.2009
- Me datë 27.02.2009 KEK-u e ka ngarkuar konsumatorin me ngarkesë për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë me anë të faturës DPR09HP07364 në vlerë prej 2,173.09 €. **Provë:** Fatura DPR09HP07364 e datës 27.02.2009

- Me datë 09.03.2009 konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KEK duke kundërshtuar ngarkesën për shfrytëzim të paautorizuar.
Provë: Ankesa e konsumatorit në KEK
- Me datë 21.04.2009 KEK-u – Departamenti për Konsumator iu është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar ankesën.
Provë: Përgjigja e KEK-ut
- Me datë 27.04.2009 konsumatori ka apeluar përgjigjen e KEK-ut në DMK të ZRRE-së.
Provë: Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE-së

DMK në ZRRE duke analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga KEK-u dhe konsumatori, ka vërejtur se:

- ✓ Gjatë realizimit të shqyçjës me datë 14.11.2007 është konstatuar se njehsori ka qenë pa vula (bllomba) distributive mirpo nuk ka pasur anashkalim të matjes dhe as ndonjë veprim tjetër që ka pasur për qëllim pengimin e matjes së energjisë së konsumuar. Pasiqë është realizuar shqyçja nga rrjeti elektrik zyrtaret e autorizuar të KEK-ut kanë vulosur (bllombuar) njehsorin elektrik me nr A10018630.
Provë: Procesverbali i KEK-ut nr. 027602 dhe fotot e njehsorit
- ✓ Nga kartela e transaksioneve të konsumatorit nuk vërehet se pas shqyçjes së datës 14.11.2007 konsumatori të jetë përgjigjur në pagesën e borxhit në mënyrë që të bëhet kyçja në rrjetin elektrik, konsumatori është kyçur në rrjetin elektrik (vete-rikyçur) pa pëlqimin e KEK-ut, dhe nga kjo rikyçje, KEK-u nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për të mos e furnizuar me energji elektrike konsumatorin i cili është kyçur në rrjetin elektrik pa bërë pagesën e borxhit apo marrëveshje pagesë .
Provë: kartela e transaksioneve të konsumatorit
- ✓ KEK-u ka lexuar dhe faturuar çdo muaj konsumatorin, zyrtari i KEK-ut i cili bënë leximin e konsumit në njehsorin elektrik nuk ka paraqitur në fletoren zyrtare (listën e leximit) asnjë parregullsi për sa i përket pamjes vizuale të njehsorit duke përfshirë edhe vulat distributive.
Provë: Dëshmia nga KEK-u
- ✓ Procesverbali i datës 12.02.2009 i përpiluar nga zyrtaret e KEK-ut ka konstatuar se njehsori elektrik ka qenë pa vula distributive dhe tri urat e tensionit kanë qenë të larguara në këtë mënyrë është pamundësuar matja e energjisë së konsumuar, nën mbështetjen e këtij konstatimi shërbimi i faturimit ka llogaritur faturën e rikthimit të humbjeve me numër DPR09HP07364 e datës 27.02.2009.
Provë: Procesverbali i datës 12.02.2009 dhe fatura DPR09HP07364 e datës 27.02.2009
- ✓ Gjatë kalkulimit të faturës DPR 09HP07364 shërbimi i faturimit nuk ka bërë asnjë analizë paraprake për rrjedhjen e historikut të këtij konsumatori, pasi që ky shërbim ka të gjitha

informatat që merren nga shërbimi i leximit për të gjitha parregullsitë që ndodhin në njehsorin elektrik e që mundë të vërehen me shikim vizual.

- ✓ Shërbimi i faturimit ka kalkuluar faturën për rikthim të humbjeve duke u kthyer për pesëmbëdhjete (15) muaj prapa nga intervalet kohore të procesverbaleve të datës 14.11.2007 dhe procesverbalit të datës 12.02.2009, duke mos hyre fare në analize që ky konsumatorë në mes të këtyre dy intervaleve kohore është lexuar faturuar dhe nuk është paraqitur asnjë parregullsi nga lexuesi i cili me përshkrimin e vendit të punës është i obliguar që parregullsitë të cilat mundë të hase gjatë punës së përditshme duhet të shënoj në fletoren zyrtare (listën e leximit).
- ✓ Në procesverbalin nr 270278 të datës 13.02.2009 ekipet zyrtare të shërbimit të kontrollës ka konstatuar se për shkak të mungesës së bulonave të kapakut nuk mund të vulozet (bllombohet) njehsori dhe nuk kanë ndërmarrë asnjë veprim tjetër për të pamundësuar konsumatorit largimin e urave.
- ✓ Sipas analizave të rrjedhjes së energjisë elektrike shihet se mesatarja e shpenzimit të energjisë prej datës kur është shkyçur nga rrjeti (14.11.2007) e deri me datën kur ka dalur ekipi i kontrollës së KEK-ut (13.02.2009) është **1,046.13 kWh**.
Provë: Rrjedhja e energjisë elektrike
- ✓ Sipas analizave të rrjedhjes së energjisë elektrike shihet se mesatarja e shpenzimit të energjisë për një periudhë të caktuar (11/2006 e deri 10/2007) është **545.83 kWh**.
Provë: Rrjedhja e energjisë elektrike

DMK në ZRRE pas analizimit të dëshmive të paraqitura i rekomandon Bordit të ZRRE-së që të **pranojë pjesërisht** ankesën e konsumatorit.

Bordi i ZRRE-së ka rishikuar të gjitha dokumentet e paraqitura dhe ka vendosur që ta **pranojë pjesërisht** ankesën e konsumatorit për arsyet e paraqitura në rekomandimin e DMK të ZRRE-së,

Sipas këtij vendimi, KEK-u është i obliguar që:

1. KEK-u faturën për rikthimin e energjisë së humbur duhet ta beje vetëm për periudhën nga leximi i fundit i konsumit në njehsorin elektrik deri të konstatimi i zyrtareve të shërbimit të kontrollës me anë të procesverbalit të datës 13.02.2009.
2. KEK-u obligohet të shkarkoj konsumatorin prej faturës DPR09HP07364 në vlerë prej 2,173.09 €.

Këshillë Juridike: Kundër këtij Vendimi, pala ka të drejtë të iniciojë procedurë gjyqësore në Gjykatën Kompetente të Prishtinës, brenda **katërmbëdhjetë (14) ditësh** prej ditës së pranimimit të këtij Vendimi.

Bordi i ZRRE-së:

Dr. Ali Hamiti, kryesues

Theranda Beqiri, anëtare

Dr. Nysret Avdiu, anëtar

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar